

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT
DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE, TIRANA 1

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Tirana 1**, me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 103, datë 07.08.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 311/15, datë 07.08.2014, i ka rekomanduar z. Koço Bello, Drejtor i ALUIZNI Tirana 1, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1, të merren masa për derdhjen në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë të detyrimeve të llogaritur e ndaluar nga paga punonjësve për tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimet shoqërore e shëndetësore me **vlerë 39,625,821 lekë**, nga e cila: tatim mbi të ardhurat 10,370,868 lekë dhe kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 29,254,953 lekë.

Menjëherë

2. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1, të rakordohet dhe të plotësohet sistemi digjital me vetëdeklarimet e pahedhura nga sistemi manual për **2443 raste**, në bazë të dokumentacionit që disponohet dhe të korrespondencës me Nj.Q.V, institucionet dhe subjekte të ndryshëm, si dhe të bëhet azhurnimi me Planin e Përgjithshëm Vendorë të Bashkisë Tiranë (PPV), për legalizimin e objekteve informale në zbatim të këtij plani.

Menjëherë dhe vazhdimisht

3. Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 1, të merren masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacion origjinal të pronësisë mbi pasurinë (truallin ose ndërtesën), ose fotokopje e noterizuara.

Vazhdimisht

4. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1, të hartoj rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit, duke ndarë detyrat për çdo sektor dhe për punonjës, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 289, datë 17.05.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/ndërtimeve informale (ALUIZNI), të ndryshuar, dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 82, datë 03.05.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së degëve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale”.

Menjëherë

5. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1, të nxirret urdhri i brendshëm për kryerjen e inventarizimit të gjithë dosjeve dhe dokumentacionit që administrohet në to, të vendoset

detyrimisht numri i çdo dokumenti sipas radhës në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 24, germa “b” dhe neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror”, si dhe neni 7, pika 1.1, neni 8, neni 10, pika “ç”, neni 12 dhe 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, si dhe Rregullores së Brendshme të ALUIZNI-t, pika 8.4 (sektori i arshivës dhe protokollit, pika 2,3 dhe 6).

Brenda muajit Dhjetor 2014

6. T’i kërkohet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, *për sa poshtë vijon:*

-në 5(pesë) rast, legalizimi i objektit informal është kryer pa u mbyllur etapat e procesit të ankimit në gjykatë, veprime në kundërshtim me nenin 26, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, dhe pikës 6, të VKM, nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, i ndryshuar.

-në 8(tetë) raste, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 31, pika 1, germa “a” dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, pikën 2, germa “e” dhe pika 4, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, me ndryshime, Vendimit të KB nr. 4, datë 23.06.2004 “Për miratimin e vijës kufizuese të Parkut të Liqenit Artificial”, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim të KKT-së nr. 1, datë 15.02.2013, pasi objektet janë legalizuar në zonë të gjelbër të parkut të liqenit artificial.

-në 19 (nëntëmbëdhjetë) raste, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 2, pika 4 dhe 4.2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pika 2 germa “b”, pika 8, e VKM nr. 438, datë 28.06.2006, me ndryshime, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim të KKT-së nr. 1, datë 15.02.2013, pasi objektet informate janë legalizuar në troje private ku janë planifikuar ndërtime të kateve të larta sipas PPV.

-në 32(tridhjetedy) raste, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 2, pika 4, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM Nr. 438, date 28.06.2006, pika 2/b, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim të KKT-së nr. 1, datë 15.02.2013, pjesën III-Rregullat mbi sistemin rrugorë dhe transportin (skema e miratuar e rrjetit rrugorë), të Rregullores së PPV, pasi objektet informate të legalizuara prekin strukturës e rrugës.

-në 1(një) rast, objekti është legalizuar në kundërshtim me neni 42, pika 2 & 3, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006, i ndryshuar, si dhe pika 2, germa “c”, e VKM nr. 438, date 28.06.2006, pasi gjysma e objekti informal ndodhet brenda zonës së Qytetit Studenti, nga pamjet me automat.

-në 1(një) rast, objekti është legalizuar në kundërshtim me nenin 39 dhe 42, pika 2, e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, dhe pikën 2, germa “e”, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006,i ndryshuar, si dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizime SH.A”, pjesa e dytë, sistemet e furnizimit me ujë, pika 2, nënpika 2.12.2, pasi

objekti informal është ndërtuar në një distancë nga depo e Ujit Qesarat, Komuna Dajt prej 10 ml, ndërkohë që duhet jo më pak se 20 ml.

-në 4 (katër) raste, legalizimi i shtesave në objekte me leje ndërtimi, janë në kundërshtim me nenin 37, germa “a” dhe “b”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pasi në dosje nuk gjendet dokument për të garantuar qëndrueshmërinë konstruktive të objektit në legalizim.

-në 7 (shtatë) raste, legalizimi i objekteve është në kundërshtim me nenin 4, pika 1, nenin 39 dhe 40, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pika 8.1, të VKM nr. 438 datë 28.06.2006, i ndryshuar, si dhe shkresën nr. 5102, datë 18.05.2012 të INUV Bashkia Tiranë.

-në 4 (katër) raste, legalizimi i objekteve është në kundërshtim me nenin 4, pika 1, nenin 39 dhe 40, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pika 8.1, të VKM nr. 438 datë 28.06.2006, i ndryshuar, si dhe shkresave nr. 10.73/4, datë 01.10.2008 të METE dhe nr. 306, datë 02.07.2008 të Inspektorati Qendror Teknik të METE.

Brenda muajit Shtator 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohe në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **163,479,234 lekë**, nga **60 persona**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Në vlerën 569,852 lekë në ngarkim të **4 punonjësve**, përkatësisht:

- **vlera 197,358 lekë** në ngarkim të punonjësës *F.N.*
- **vlera 126,113 lekë** në ngarkim të punonjësës *M.B.*
- **vlera 213,124 lekë** në ngarkim të punonjësës *E.H.*
- **vlera 33,257 lekë** në ngarkim të punonjësës *O.S.*

për paga të dhëna në kundërshtim me kërkesat e me klasën e IX-të, lidhja II të VKM nr. 690, datë 09.10.2012 dhe lidhjes 2, të VKM nr. 545, datë 11.08.2011, i ndryshuar, me VKM nr. 524, datë 14.08.2012.

Brenda muajit Shtator 2014

2. Vlera prej 267,032 lekë, në ngarkim të poseduesit të pronës së legalizuar “*K... FB*” *sh.p.k.*, mos llogaritje dhe pagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 23, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Brenda muajit Shtator 2014

3. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1, të merren masa për saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së detyrimit prej **159,491,750 lekë** të **54 persona**, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, dhe VKM nr. 309, datë 15.09.2008 “Për zbatimin e procedurave të përcaktuara në manualin “Për mënyrën e llogaritjes dhe plotësimin e formularëve për pagesën e detyrimeve financiare të procesit të legalizimit”, pasi llogaritja e detyrimeve të tarifës së parcelës ndërtimore të objekteve informale (*banesë dhe të kombinuara*), është bërë në kundërshtim me VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe disa komuna”.

5. Vlera prej 3,150,600 lekë, në ngarkim të poseduesit të pronës së legalizuar “A.C.”, për legalizimin e objektit informal pa likuiduar totalisht tarifën e parcelës ndërtimore të objektit informal, në kundërshtim me germën “f” të nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pika 11 e Kreut II, të VKM nr. 437, datë 28.6.2006, si dhe germa “a” dhe “b” e pikës 1, të VKM nr. 438, datë 28.6.2006, i ndryshuar.

6. Për të gjithë emrat e evidentuara nga pika 1 deri në pikën 5, të njoftohet ZVRPP dhe ZQRPP të marrë masa për vendosjen e barrës (shënim hipotekor), deri në shlyerjen e detyrimit për tu nxjerrë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe germa “d” e nenit 12, të kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

I. Për Drejtorinë Rajonale të ALUZNI-t, Tirana 1

I/A “Zgjidhjen e kontratës së punës”

- 1. z. K.B.** me detyrë Drejtor ALUIZNI-t, Tirana 1;
 - 2. z. R.D.** me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizim e Urbanizim Tirana 1;
 - 3. z. T.B.** me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Urbanizim Tirana 1;
 - 4. z. B.Gj.** me detyrë ish-Specialist Jurist në Drejtorinë Rajonale ALUIZNI Tirana 1;
- a)** Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimeve, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin të objektit informal (leje legalizimi), si;
- në 5(pesë) rast**, legalizimi i objektit informal është kryer pa u mbyllur etapat e procesit të ankimit në gjykatë, veprime në kundërshtim me nenin 26, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, dhe pikës 6, të VKM, nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, i ndryshuar.
- në 8(tetë) raste**, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 31, pika 1, germa “a” dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, pikën 2, germa “e” dhe pika 4, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, me ndryshime, Vendimit të KB nr. 4, datë 23.06.2004 “Për miratimin e vijës kufizuese të Parkut të Liqenit Artificial”, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim të KKT-së nr. 1, datë 15.02.2013, pasi objektet janë legalizuar në zonë të gjelbër të parkut të liqenit artificial, konkretisht për dosjet.

-në 19 (nëntëmbëdhjetë) raste, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 2, pika 4 dhe 4.2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, pika 2 germa “b”, pika 8, e VKM nr. 438, datë 28.06.2006, me ndryshime, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim të KKT-së nr. 1, datë 15.02.2013, pasi objektet informate janë legalizuar në troje private ku janë planifikuar ndërtime të kateve të larta sipas PPV.

-në 32(tridhjetedy) raste, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 2, pika 4, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, VKM Nr. 438, date 28.06.2006, pika 2/b, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim të KKT-së nr. 1, datë 15.02.2013, pjesën III-rregullat mbi sistemin rrugorë dhe transportin (skema e miratuar e rrjetit rrugorë), të Rregullores së PPV, pasi objektet informate të legalizuara prekin strukturës e rrugës.

-në 1(një) rast, objekti është legalizuar në kundërshtim me neni 42, pika 2 & 3, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006, i ndryshuar, si dhe pika 2, germa “c”, e VKM nr. 438, date 28.06.2006, pasi gjysma e objekti informal ndodhet brenda zonës së Qytetit Studenti, nga pamjet me automat.

-në 1(një) rast, objekti është legalizuar në kundërshtim me nenin 39 dhe 42, pika 2, e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, dhe pikën 2, germa “e”, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006,i ndryshuar, si dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizime SH.A”, pjesa e dytë, sistemet e furnizimit me ujë, pika 2, nën-pika 2.12.2, pasi objekti informal është ndërtuar në një distancë nga depo e Ujit Qesarat, Komuna Dajt prej 10 ml, ndërkohë që duhet jo më pak se 20 ml.

-në 4 (katër) raste, legalizimi i shtesave në objekte me leje ndërtimi, janë në kundërshtim me nenin 37, germa “a” dhe “b”, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pasi në dosje nuk gjendet dokument për të garantuar qëndrueshmërinë konstruktive të objektit në legalizim.

-në 7 (shtatë) raste, legalizim i objektit është në kundërshtim me nenin 4, pika 1, nenin 39 dhe 40, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pika 8.1, të VKM nr. 438 datë 28.06.2006, i ndryshuar, si dhe shkresën nr. 5102, datë 18.05.2012 të INUV Bashkia Tiranë.

-në 4 (katër) raste, legalizim i objektit është në kundërshtim me nenin 4, pika 1, nenin 39 dhe 40, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pika 8.1, të VKM nr. 438 datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriteve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, si dhe shkresave nr. 10.73/4, datë 01.10.2008 të METE dhe nr. 306, datë 02.07.2008 të Inspektorati Qendror Teknik të METE.

b) Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore prej 159,491,750 lekë për 54 persona, si një e ardhur e munguar me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime në kundërshtim me nenin 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe disa komuna”.

c) Për shkelje, të meta e mangësitë e konstatuara në 1 (një) raste, në legalizimin e objektit informal pa likuiduar totalisht vlerën e parcelës ndërtimore **prej 3,150,600 lekë**, si një e

ardhur e munguar me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime në kundërshtim me nenin 27, pika f, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, dhe VKM nr. 1620, datë 26.11.2008.

I/B “Vërejte me paralajmërim për Zgjidhjen e kontratës së punës”.

1. Znj. T.K. me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizimit ALUIZNI Tirana 1

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimeve, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin të objektit informal (leje legalizimi), si;

- **në 4 (katër) raste**, legalizimi i objekteve informale nuk plotësojnë kriteret ligjore të nenin 2, pika 4, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, dhe germa “b” e pikës 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo", pasi objektet informale të legalizuara prekin strukturën e rrugës në dosjet 996, 3125,258 dhe 2016.

II. Për të meta dhe mangësitë e konstatuara dhe të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për ish-punonjësit e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Tirana 1: **B.F., V.C. dhe D.P.**, Dhënia e masave disiplinore quhet e ezauruar. Këta punonjës kanë një periudhë kohore mbi 6 muaj që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, në zbatim të kontratave individuale të lidhura sipas Kodit të Punës, dhe shkeljet e konstatuara janë të nivelit të dhënies së masave disiplinore “*Ndërprerje të marrëdhënieve të punës*”, për të cilën i lihet detyrë Drejtorisë së rajonale të ALUIZNI-t Tirana 1 që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të informojë Departamentin e Administratës Publike për masat e rekomanduara për këta ish punonjës.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 311/16, datë 07.08.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranw:

1. Z. K.B. me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Tirana 1

Z. R.D. me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim/Urbanizimit, ALUIZNI Tirana 1

3. Z. T.B. me detyrë ish-P/Sektorit të Urbanizim ALUIZNI Tirana 1

4. Z. B.Gj. me detyrë ish-Specialist Jurist në ALUIZNI Tirana 1

Nga Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Tiranw 1, me shkresë nr. 989/72, prot, datë 29.08.2014, protokolluar në KLSH me nr.311/18 datë 01.09.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Hysen Metko, Kristaq Gjurgjaj, Aleksandër Papadimitri dhe Luan Kuka më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT